



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
PREFEKTI

Nr. 123 Prot.

Fier, më 22.01.2024

URDHËR

Nr. 27, datë 22.01.2024

PËR

NGRITJEN E KOMITETIT RAJONAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT
DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM TË QARKUT FIER.

Mbështetur në nenin 20 pika 1 të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" dhe në zbatim të urdhrit Nr. 185, datë 31.10.2023 të Kryeministrit "Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm",

URDHËROJ:

1- Krijimin e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm Qarkut Fier me përbërje si më poshtë vijon:

I. Prefekti i Qarkut Fier	Kryetar
II. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë	Anëtar
III. Drejtori i Drejtorisë së SHISH-it Fier	Anëtar
IV. Drejtori i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë	Anëtar
V. Drejtori Rajonal i Shërbimit Social Shtetëror Fier	Anëtar
VI. Drejtori Rajonal i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Fier	Anëtar
VII. Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Punës Fier	Anëtar
VIII. Drejtori i Drejtorisë së Formimit Profesional Fier	Anëtar
IX. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier	Anëtar
X. Drejtori i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier	Anëtar
XI. Drejtori i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lushnje	Anëtar

- XII. Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Mallakastër Anëtar
- XIII. Drejtori i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier Anëtar
- XIV. Drejtori i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Fier Anëtar
- XV. Shefi seksionit të Policisë Kriminale të Policisë Ushtarake Vlorë Anëtar

2. Në takimet e Komitetit Rajonal, në rastet kur vlerësohet e nevojshme dhe sipas çështjeve që do të trajtohen, me kërkesë të kryetarit, mund të ftohen të marrin pjesë kryetari i Këshillit të Qarkut, kryetari/kryetarët i/e bashkisë/bashkive, drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore, anëtarë të bashkësive fetare, përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizata apo agjenci të tjera.

3. Komiteti Rajonal ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Shërben si partner dhe autoritet përgjegjës në nivel qarku për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit të rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
- b) Identifikon dhe referon pranë Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, (në vijim QKEDH) individët apo grupet vulnerabel në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar në nivel qarku, nëpërmjet vlerësimit të raportimeve dhe problematikave të diskutuara në mbledhjet periodike nga anëtarët e Komitetit Rajonal.
- c) Në bashkëpunim me QKEDH-në, ndjek të gjitha veprimet, masat dhe aktorët e përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset e rehabilitimit, riintegritimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës.
- ç) Kryen vlerësime periodike për fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel qarku, në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025, si dhe planeve përkatëse të veprimit,
- d) Ndërmerr masa për rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet me qëllim parandalimin e radikalizmit dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet tryezave të rumbullakëta, takimeve informuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit për këtë qëllim.
- h) Shërben si urë lidhëse për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuar në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara në qark.
- e) Zbaton me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga kryetari i Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.
- f) Raporton periodikisht **një herë në tre muaj**, nëpërmjet kryetarit të Komitetit Rajonal te Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, për të gjithë veprimtarinë e tij. Raporti duhet të jetë produkt i punës të të gjithë anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe përmbajtja e raportit duhet të japë informacion vetëm për periudhën për të cilën raportohet.
- g) **Miraton rregulloren e funksionimit të Komitetit Rajonal në koordinim me QKEDH-në.**
- h) I propozon Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm plane dhe strategji konkrete për adresimin e çështjeve e të problematikave që kanë të bëjnë me parandalimin e radikalizmit, luftën kundër

ekstremizmit të dhunshëm si dhe rehabilitimin e të riadhesuarve nga zonat e konfliktit.

4. Struktura e raportit sipas shkronjës “ë”, të pikës 3, të këtij urdhri, duhet të përmbajë:
 - a) një përmbledhje të veprimtarisë së Komitetit Rajonal për periudhën, për të cilën raportohet, si dhe informacione në fushën e veprimit të secilit anëtar;
 - b) konstatime dhe problematika të hasura, si dhe propozime për adresimin e tyre;
 - c) të dhëna statistikore apo tregues të arritjeve dhe rezultateve kryesore;
 - ç) të dhëna statistikore të përditësuara për periudhën, për të cilën raportohet;
 - d) informacion për planifikimin dhe programet për të ardhmen.

4.1. Të dhënat statistikore të përditësuara për periudhën, për të cilën raportohet, duhet të përfshijnë informacion të përpunuar, të ardhur nga të gjitha strukturat që janë pjesë e Komitetit, dhe të përmbajnë informacion në nivel qarku për:

- a) rastet apo fenomenet e evidentuara nga Policia e Shtetit;
- b) rastet apo fenomenet e evidentuara nga punonjësit socialë në njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- c) rastet apo fenomenet e evidentuara nga Shërbimi Informativ i Shtetit;
- ç) rastet apo fenomenet e evidentuara nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale që veprojnë në qark;
- d) rastet apo fenomenet e evidentuara nga sistemi i arsimit parauniversitar;
- dh) rastet apo fenomenet e evidentuara nga sistemi i shëndetësisë;
- e) rastet apo fenomenet e evidentuara nga Forcat e Armatosura;

- ë) rastet apo fenomenet e evidentuara nga komunitetet fetare;
- f) rastet apo fenomenet e evidentuara nga shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare që operojnë në qark;
- g) rastet apo fenomenet e evidentuara nga aktorë të tjerë.

4.2. Raporti duhet të hartohet dhe të përcillet në formën e një shkrese zyrtare të nënshkruar nga prefekti i qarkut, në cilësinë e kryetarit të Komitetit Rajonal, me datë dhe me numër protokollit të institucionit që e dërgon.

5. Kryetari i Komitetit Rajonal në çdo qark kryen këto detyra:

- a) Organizon dhe drejton veprimtarinë e komitetit, bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe në planet e veprimit.
- b) Raporton një herë në tre muaj, në emër të Komitetit Rajonal te Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm për veprimtarinë e Komitetit Rajonal dhe proceset e rehabilitimit, riintegrimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, në nivel qarku.
- c) Shërben si urë lidhëse koordinuese ndërmjet Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe qarkut për bashkërendimin e veprimtarisë për parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të rehabilitimit, riintegrimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) është Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (Koordinatori Kombëtar).

7. Komiteti Rajonal mbledhet, si rregull, **një herë në tre muaj**, me kërkesë të kryetarit të saj. Në situata dhe raste të veçanta, sipas vlerësimit të kryetarit të Komitetit Rajonal, ky i

fundit mund të mblidhet edhe më shumë se një herë në tre muaj. Në çdo rast, njoftohet paraprakisht Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

8. Komiteti mund të mblidhet dhe me kërkesën e Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në çdo moment, në raste urgjente dhe sa herë e gjen të arsyeshme ky i fundit, me qëllim bashkërendimin e punës, trajtimin dhe adresimin e problematikave.
9. **Anëtarët e Komitetit Rajonal të raportojnë periodikisht një herë në muaj, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë te Kryetari i Komitetit.**
10. Në mbështetje të veprimtarisë së Komitetit Rajonal të ngrihet sekretariati teknik, i cili është pjesë e administratës së prefektit të qarkut. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Komitetit Rajonal.
11. **Sekretariati teknik ka këto detyra:**
 - a) Mban kontakt me të gjithë anëtarët e Komitetit Rajonal, Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm apo aktorët e tjerë që mund të ftohen në tryeza teknike me kërkesën e kryetarit të Komitetit Rajonal;
 - b) Njofton anëtarët për takimet e Komitetit Rajonal, si dhe siguron paraqitjen dhe shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara;
 - c) Siguron zhvillimin e mbledhjes, shkëmbimin dhe administrimin e informacionit dhe të dhënave në nivel qarku për detyrat e caktuara nga Komiteti Rajonal;
 - ç) Harton raporte dhe plane pune të Komitetit Rajonal.
12. Me qëllim koordinimin e punës dhe shkëmbimin e përvojave pozitive, Komiteti Rajonal mund të organizojë tryeza ndërinstitucionale teknike për këtë qëllim.
13. Ngarkohen të gjithë anëtarët e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, sipas pikës 1, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Rajmonda BALILAJ

